

V E N D I M

Nr.39, datë 21.1.1999

PËR RISHIKIMIN E FUNKSIONEVE, TË STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË KRYEMINISTRISË DHE TË DISA MINISTRIVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rishikimi i funksioneve të Kryeministrit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Pushtetit Lokal, për të rritur efektivitetin në realizimin e detyrave, sipas fushave përkatëse.

Për ndryshimet në funksionet ekzistuese të përgatiten, sipas rastit, projektet e akteve ligjore dhe nënligjore, me argumentet përkatëse.

2. Rishikimin e strukturave organizative, organikat dhe mënyrën e shpërndarjes së funksioneve në secilin organ dhe për plotësimin e vendeve vakant të zbatohen dispozitat ligjore.

3. Rishikimi i funksioneve dhe i organikave për Kryeministrinë dhe për Ministrinë e Drejtësisë të përfundojë brenda muajit mars 1999, ndërsa në Ministrinë e Financave dhe atë të Pushtetit Lokal brenda muajit qershor 1999.

4. Deri në miratimin e strukturave të reja, plotësimi i vendeve vakant të bëhet nga ministrat përkatës, duke informuar Departamentin e Administratës Publike në Kryeministri.

5. Për nevojat aktuale, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqiten propozimet dhe, pasi të merret miratimi, të procedohet menjëherë, për plotësimin e vendeve vakant, në përputhje me rregullat në fuqi.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Koordinimit Qeveritar, ministri i Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko